



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.60/01-3626/21
Kaçanik, 09.02.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **I-rë (parë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2021, mbajtur me datë 09 Shkurt 2021 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin 6 anëtarë: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Kodra- LVV , Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Shemsedin Abazi - KMLDNJ dhe Naim Hysa- Kryqi i Kuq. Ndërsa Elmihane Krasniqi – Malsiu nga OJQ HANDIKOS ka munguar në mbledhje. Nga Ekzekutivi i komunës mori pjesë Diana Reka- Drejtoreshë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtëse: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e I-rë (parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2021, data 09 Shkurt me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete e vitit 2020;
2. Gjendja e Pandemisë me Covid-19; dhe
3. Të ndryshme.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta , Sa i përketë procesverbalit jemi njoftuar nga Arbnora se për shkaqe teknike nuk mund të procedohet në këtë mbledhje, por në mbledhjen tjetër vijuese. Kjo do të thotë që pika e parë e rendit të punës shtyhet për mbledhjen tjetër vijuese.Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 2 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

2. Gjendja e Pandemisë me Covid-19

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Së bashku me anëtarët e komitetit kemi vizituar QKMF në Kaçanik.Ishim tek drejtori i QKMF-s, mirëpo nuk ishte i lirë. Këtu e kemi edhe drejtoreshën në

Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila mund të na njofton më gjerësisht. Fillimisht ju jap fjalën juve anëtarëve të Komitetit nëse keni ndonjë pyetje , pastaj ja japim fjalën drejtoreshës.

Znj.Kaltrina Kodra, nëse ke mundësi një përmbledhje të takimit, pasi që disa nuk kemi marrë pjesë.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Ja jap fjalën Nazifës pasi që edhe ajo ka qenë pjesëmarrëse në takim.

Znj.Nazife Krasniqi, Ishim në vizitë në QKMF. Znj. Filkizare na njoftoi me gjendjen e QKMF-së. Sipas saj, sa i përket komunës , sa kanë pasur mundësi na kanë ndihmuar, por nga qendra na kanë lënë anash lidhur me njoftimet për pacientët me Covid-19. Sipas saj, së pari njoftohet Kryetari i komunës, pastaj asistentja edhe inspektoriat. Kur të vjen pacienti me Covid-19 në QKMF ne nuk jemi në dijeni dhe i kryejm intervenimet por bëhet vonë. I kishte disa preokupime lidhur me mungesën e mjekëve në QKMF, për shkak se kanë shkuar në specializim. Sipas saj 14 mjek shkuan në specializim. Sipas saj në QKMF janë vetëm 3 mjek. Si funksionon QKMF me vetëm 3 mjek?

Znj.Diana Reka, Sa i përket informimit rreth pacientëve me Covid-19 , në çdo komunë , IKSHP-ja së pari njofton Kryetarin e komunës, pastaj Kryetari njofton drejtorin/drejtoreshën e drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, pastaj drejtori/ drejtoresha njoftojnë drejtorin e QKMF-së dhe inspektorin. Në kohë shumë të shkurt njoftohen të gjithë. Rregullat e IKSHP-së nuk mund ti ndryshojmë. Vendimet për personat me Covid-19 i bënë inspektori sanitar- Besnik Bajra. I njeiti problem është në të gjitha komunat, ka vonesa në rezultate nga IKSHP. Sa i përket mjekëve është mungesë e mjekëve në të gjitha komunat. 11 mjek kanë shkuar në specializim, disa me vetfinancim. Por të gjithë i ka marrë Ministria e Shëndetësisë. 2 mjek janë pranuar në QKMF. Dje e kemi shpallë konkursin edhe për 3 mjek. Procedura për pranim shkon për më shumë se një muaj. Ka raste në komunat tjera kur hapin konkurse për mjek dhe nuk aplikon askush. Sa i përket numrit të mjekëve 3 mjek janë vetëm paradite, por mund të jetë ndonjë keqkuptim.

Znj.Kaltrina Kodra, Nuk është keqkuptim, pos sa mjek janë në QKMF?

Znj.Diana Reka, 3 mjek punojnë në ndërrim të parë , 2 mjek në ndërrim të dytë dhe një mjek në ndërrim të natës, kujdestari.

z.Naim Hysa, Në ndërrim të parë dy mjek dhe dr.Ekrem Dullovi. Sa i kam parë une po flas.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Sa i përket gjendjes në QKMF, nuk kemi vërejtje. Problemi ishte në qendër për vonesë të informimit nga IKSHP. Ky problem për njoftimin me vones për Covid-19 është edhe në komuinat tjera.

z.Naim Hysa, Në fillim kemi marrë informata për pacientët me Covid-19 përmes grupit që jemi në shtab, por është ndërprerë, nuk e dijmë arsyen.

Znj.Diana Reka, Edhe në kolegji me të drejtorëve të DSHMS e kemi diskutuar çështjen e informimit. Më kanë pyetur se si i kemi njoftuar familjarët. Në komunën tonë i ka njoftuar IKSHP. Sepse në një komunë drejtoresha e DSHMS i ka njoftuar vet lidhur me rezultatin , të gjithë personat që kanë bërë testin për Covid-19.

z.Naim Hysa, Në komunën tonë janë informuar me kohë falë punës së shtabit komunal për pandeminë.

Znj.Nazife Krasniqi, Kohët e fundit janë njoftuar më shpejtë me rezultate.

z.Naim Hysa, Me sa duket janë duke e përdorur një metodë që kush është me rezultat negativ , nuk e njoftojnë, sepse unë kisha një rast në familje që e ka bërë testin dhe ka pritur disa ditë dhe nuk është njoftuar. Kur ka shkuar në IKSHP në Ferizaj i kanë thënë pasi që ke dal me rezultat negativ nuk të kemi njoftuar.A janë bërë teste në komunën tonë? A dihet numri se sa kanë bërë teste dhe se sa kanë rezultat pozitiv dhe sa negativ?

Znj.Diana Reka, Janë bërë teste.Rezultatet e ditës së djeshme janë të gjitha negativ , vetëm një rast pozitiv.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Shqetësuese është se ato që bëjnë teste, ka disa raste që nuk mbyllen.

Znj.Diana Reka, Me ato raste merren policia.Kryetari e njofton policinë dhe policia merret me rastin. Nga të gjitha rastet në komunën tonë 29 raste janë aktiv me Covid-19. Që nga fillimi i pandemisë numri i të infektuarve me Covid-19 është 367 raste , të shëruar janë 326 raste ,ndërsa me vdekje 11 raste.

Të ndryshme

z.Naim Hysa, Para dy jave isha në QKMF, në ora 2 të mëngjesit dhe nuk kishte barnatore hapur. A ka marrë masa inspektorati për këtë çështje, ose ti si drejtoresh e DSHMS a ke mundësi të merresh me inspektorat? A kanë orar barnatoret? Qytetari ka shku në Ferizaj me blej diçka për arsye se nuk kishte barnatore të hapur.

Znj.Diana Reka, Së pari duhet ti falenderojmë punëtorët shëndetësor që ka disa që vet i blejnë disa ampula dhe i mbajnë për çdo rast që ka nevojë.

z.Naim Hysa, A keni mundësi të keni fond si Drejtori e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale?

Znj.Diana Reka, Nuk mund të hapim tender për barnat esenciale. Është problem në të gjitha komunat.Prej tetorit të vitit 2019 nuk jemi furnizuar aspak nga Ministria e Shëndetësisë. DSHMS e ka për obligim hartimin e orarit për barnatoret .Inspektori i tregut është në kuadër të Drejtorisë së Financave,ai duhet të merret me këtë problem.Unë kam nevojë që çdo natë të dalë inspektori i tregut në inspektim.Për të punuar barnatorja që është në kujdestari, barnatoret tjera duhet të mbyllen në ora 22:00.

z.Naim Hysa, Si të zgjidhet problemi? Se ka shumë qytetar që nuk mund të shkojnë në një komunë tjetër.

Znj.Diana Reka, Në momentin që barnatorja që është në kujdestari nuk është e hapur , duhet të lajmërohet policia. Mirëpo nuk e kemi me ligj të udhërohen të jenë të hapura.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, A keni biseduar me pronarët e barnatoreve?Pasi që e keni caktu që një barnatore të mbajë kujdestari, ajo barnatore duhet të jetë e hapur.Mirë është të rekomandohen barnaret të punojnë.Pronarët

Znj.Diana Reka, Nëse inspektori duhet të del natën në inspektim , ditën duhet të ketë pushim ose duhet t'i kompenzohet.Është vetëm një inspektor dhe ndoshta nuk mund t'i arrijë të gjitha.


z.Naim Hysa, A kanë të drejt të gjobiten? Kur të inspektosh brenda muajit 4 herë me dalë natën, atëherë edhe pronarët e barnatoreve vetëdijesohen.

Znj.Diana Reka, Unë nuk kam kompetencë të flas për një drejtor tjetër. Orarin e barnatoreve e hartojmë ne si drejtori. Gjendja në QKMF është shumë e mirë , përveq mungesës së barnave.

z.Naim Hysa, Ne si komitet duhet të merremi me shumë probleme.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Çështja e barnatoreve duhet të zgjidhet se edhe komuna e Kaçanikut është e vogël. Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:00.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesuese e Komitetit
Lirije Luta

